

Fjalimi i studentes Rinesa Hyseni, përfaqësuese e të diplomuarve në ceremoninë e diplomimit të UKZ-së 2025

I nderuar rektor,

Të nderuar profesorë, staf tjetër akademik e administrativ,

Familjarë të dashur dhe studentë të nderuar,

Sot jemi mbledhur për të festuar një ndër arritjet më të veçanta të jetës sonë – përfundimin e studimeve universitare dhe kurorëzimin e këtij rrugëtimi me diplomimin tonë.

Kjo ditë shënon mbylljen e një kapitulli të rëndësishëm dhe hapjen e një etape të re, të mbushur me përgjegjësi dhe sfida, por edhe me ëndrra e shpresa të reja.

Është një ndjenjë e veçantë për mua që të jem sot këtu, duke përfaqësuar studentët e diplomuar dhe duke reflektuar mbi rrugëtimin tonë akademik. Katër vitet e studimeve kanë qenë vite përpjekjesh, pune dhe sakrifice, por njëkohësisht edhe vite që na kanë dhënë miqësi të vlefshme, përvoja të paharrueshme dhe suksese të shumta. Çdo provim i kaluar, çdo projekt i përfunduar dhe çdo orë e kaluar mbi libra ka qenë pjesë e ndërtimit të këtij momenti solemn.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka qenë vendi ku kemi rritur dijen dhe karakterin tonë, ku kemi mësuar se suksesi nuk qëndron vetëm në njohuritë e fituara, por edhe në përkushtim, këmbëngulje dhe besim në vetvete.

Sot ndjej detyrimin të shpreh mirënjohje të veçantë për profesorët tanë – të cilët nuk kanë qenë vetëm mësimdhënës, por udhërrëfyes, mentorë dhe mbështetës të vazhdueshëm. Po ashtu, një falënderim i madh i takon familjeve tona, që na kanë qëndruar pranë me përkrahje dhe dashuri në çdo hap të këtij rrugëtimi.

Tani largohemi nga universiteti si të diplomuar, por jo si të përfunduar – sepse rruga e dijes është e pafund. Përpara nesh qëndron një mision i ri: të japim kontributin tonë në profesionet që kemi zgjedhur dhe të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për veten, shoqërinë dhe vendin tonë.

Në emër të studentëve të diplomuar, dua të uroj suksese të gjithëve dhe një vit të mbarë për profesorët, studentët dhe stafin e Universitetit Publik “Kadri Zeka”.

Ju faleminderit!